

VENDIM
Nr.283, datë 16.4.2004

PËR NGRITJEN E BORDIT TË KULLIMIT NË ZONËN E SHËRBIMIT TË KULLIMIT TË LEZHËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 35 e 41 të ligjit nr.8518, datë 30.7.1999 “Për ujitjen dhe kullimin”, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë dhe të Ushqimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ngritjen e bordit të kullimit në zonën e shërbimit të kullimit të Lezhës, i cili financohet nga Buxheti i Shtetit.
 2. Zona e shërbimit të kullimit të këtij bordi përbëhet nga:
 - a) zona e fushës Mat-Lezhë (LEK-1), që kullon me rrjedhje të lirë, me sipërfaqe 1500 ha;
 - b) zona e fushës Mat-Lezhë (LEK-2), që kullon me ngritje mekanike, me sipërfaqe 5000 ha;
 - c) zona e fushës së Zadrimës (LEK-3), që kullon me rrjedhje të lirë, një sipërfaqe 6500 ha dhe me ngritje mekanike, një sipërfaqe 500 ha;
 - ç) zona e fushës së Kakariqit (LEK-4), që kullon me ngritje mekanike, me sipërfaqe 2250 ha;
 - d) zona e fushës së Ishull Shëngjinit (LEK-5), që kullon me ngritje mekanike, me sipërfaqe 700 ha;
 - dh) pendët mbrojtëse nga përmytjet e detit, të lumenjve dhe të kanaleve të ujërave të larta;
 - e) sistemi i mbrojtjes nga gërryerjet e lumenjve dhe të përrenjve.
 3. Këshilli i përfaqësuesve të bordit të përbëhet nga:
 - a) 1 (një) përfaqësues nga Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit;
 - b) 3 (tre) përfaqësues nga federatat dhe shoqatat e përdoruesve të ujit, brenda zonës së shërbimit të kullimit;
 - c) 3 (tre) përfaqësues të komunave, brenda zonës së shërbimit të kullimit;
 - ç) 2 (dy) përfaqësues të bashkive, brenda zonës së shërbimit të kullimit;
 - d) 1 (një) përfaqësues i këshillit të qarkut;
 - dh) 1 (një) përfaqësues i biznesit, me veprimtari brenda zonës së shërbimit të kullimit.
 4. Anëtarët e këshillit të përfaqësuesve të shpërblehen, çdo muaj, me 5000 (pesë mijë) lekë.
 5. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti vjetor, i miratuar për Ministrinë e Bujqësisë dhe të Ushqimit.
 6. Ngarkohet Ministri i Bujqësisë dhe i Ushqimit për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano